



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201401559/6

Tiranë ___/___/2014

Lënda: *Marrjen e masave për dërgimin çdo muaj të listës së invalidëve të punës në Zyrën Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, Tiranë, në zbatim të Udhëzimit nr.1406 datë 30.07.2008 "Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit të nevojshëm për dhënien e përfitimit, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.869 datë 18.06.2008 "Për zbatimin e Ligjit Nr.7889 datë 14.12.1994 "Për Statusin e Invalidit".*

Drejtuar : **Z. Arsim RAMA**
Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore

TIRANË

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetasi S.Cri, banues në Njësinë Bashkiake nr.5, Tiranë, lidhur me mospërfitimin e së drejtës së pagesës së aftësisë së kufizuar si shtesë në pensionin e invaliditetit për periudhën 01.09.2012-01.09.2014.

Sipas shpjegimeve të parashtruara në ankesë, në muajin Shtator 2012, pas vlerësimit të gjëndjes shëndetësore, KMCAPI Tiranë e ka deklaruar me grup të plotë të invaliditetit. Ka përfituar pension invaliditeti, por nuk ka përfituar shtesën prej 3300 lekësh në muaj, si përfitim paaftësie, që nga data 01.09.2012. Ky përfitim ankuesit i njihet vetëm nga data 01.09.2014. Kjo për arsye se nga ana e KMCAPI Tiranë është pajisur me vërtetimin për përfitimin e kësaj shtese edhe për periudhat e kaluar, pas rikomisionimit, datë 25.08.2014.

Ankuesi pretendon se pavarësisht se është pajisur me vërtetimet përkatëse për të përfituar pagesën e aftësisë së kufizuar edhe për periudhën 01.09.2012-01.09.2014, atij nuk i është dhënë kjo e drejtë. Në këto kushte atij i njihet e drejta për të përfituar pagesën e aftësisë së kufizuar vetëm nga muaji Shtator 2014.

Shtetasi S.C, e konsideron këtë çështje si shkelje të të drejtave të tij të ligjshme, pasi bazuar në legjislacionin në fuqi, i takon të përfitojë shtesën mbi pensionin e invaliditetit.

Duke cilësuar mosdhënien e kësaj të drejtë në kundërshtim të plotë me përcaktimet e bëra në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.869 datë 18.06.2008 "Për zbatimin e Ligjit nr.7889 datë 14.12.1994 "Statusin e Invalidit", ankuesi ka kërkuar ndërhyrjen e Avokatit të Popullit për shqyrtimin e këtij rasti dhe mundësimimin e përfitimit të pagesës së paaftësisë.

Institucioni i Avokatit të Popullit, si një institucion kushtetues në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj, ka vendosur pranimin e ankesës dhe shqyrtimin e saj.

Për shqyrtimin e kësaj çështje, iu drejtuam me rekomandim Kryetares së Njësisë Bashkiake nr.5, Tiranë, për marrjen e masave për dhënien e menjëhershme të shtesës mujore mbi pensionin e invaliditetit, si përfitim paaftësie, shtetasit S.C, për periudhën 01.09.2012-01.09.2014.

Në përgjigje të rekomandimit tonë, na dërgojnë informacionin e mëposhtëm:

"Shtetasi S.C është paraqitur pranë Zyrës së Ndihmës Ekonomike në Njësinë Bashkiake nr.5 në muajin Korrik 2014. Ai ka paraqitur dy vërtetime të lëshuara nga DRSSH-ja Tiranë për të përfituar shtesën mbi pensionin e invaliditetit, me afat të përfitimit të pensionit të invaliditetit për periudhat: 01.09.2012-01.09.2013 si dhe 01.09.2013-01.09.2013. Të dyja vërtetimet mbajnë datën 18.07.2014.

Në mbështetje të Udhëzimit nr.1406 datë 30.07.2008, në pikën 5, kjo shtesë përfitohet një muaj mbas datës 18.07.2014, pra në muajin Gusht 2014. Nga ana e DRSSH-së Tiranë personi nuk është sqaruar për këtë përfitim dhe nuk e ka pajisur me Vertetimin Tip në momentin e përfitimit të pensionit të invaliditetit, por e kanë pajisur me këtë vërtetim dy vjet më vonë, në muajin Korrik 2014. Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë nuk jep fonde për pagesa që nuk përputhen me kuadrin ligjor të saj".

Nga dokumentacioni bashkangjitur ankesës, rezulton se:

Shtetasi S.C me vendimin nr.1177 datë 27.07.2012 është deklaruar nga KMCAP-i Tiranë me grup të dytë të invaliditetit për periudhën 01.09.2012-01.09.2013; me vendimin nr.1464 datë 30.09.2013 është deklaruar me grup të dytë të invaliditetit për periudhën 01.09.2013-01.09.2014; me vendimin nr.1585 datë 25.08.2014 është deklaruar me grup të dytë të invaliditetit për periudhën 01.09.2014-01.09.2015.

Ky shtetas është pajisur nga ana e institucioni që Ju drejtoni me dy vërtetime "Për invaliditet të plotë nga sëmundje të përgjithshme". Njëra me nr.2129 datë 18.07.2014, me anë të së cilës vërtetohet se pensionin e invaliditetit (të plotë) e përfiton për periudhën 01.09.2012-01.09.2013 dhe tjetra me nr. 2128 datë 18.07.2014, me anën e të cilit vërtetohet se pensionin e invaliditetit (të plotë), e përfiton për periudhën 01.09.2013-01.09.2014.

Në analizë të akteve ligjore e nënligjore për përfitimet e të drejtave të invalidëve të punës, konstatojme si më poshtë:

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 869 datë 18.06.2008 "Për zbatimin e Ligjit nr.7889 datë 14.12.1994 "Për Statusin e Invalidit", në pika 1, ka përcaktuar se:

"1. Personave përfitues, sipas përcaktimit të nenit 1 të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit", të ndryshuar, u jepet një shtesë mujore mbi pensionin e invaliditetit, si përfitim paaftësie, në masën:

a) 3300 (tre mijë e treqind) lekë në muaj, nëse janë invalidë të plotë, nga sëmundje të përgjithshme;

b) 2200 (dy mijë e dyqind) lekë në muaj, nëse janë invalidë të pjesshëm, nga sëmundje të përgjithshme;

c) 4000 (katër mijë) lekë në muaj, nëse janë invalidë të plotë, nga aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale;

ç) 2700 (dy mijë e shtatëqind) lekë në muaj, nëse janë invalidë të pjesshëm, nga aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale".

Ndërsa në Udhëzimin nr.1406 datë 30.07.2008 "Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit të nevojshëm për dhënien e përfitimit, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.869 datë 18.06.2008 "Për zbatimin e Ligjit Nr.7889 datë 14.12.1994 "Për Statusin e Invalidit", në pikat 8 dhe 10 të tij, thuhet shprehimisht se:

"8. Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore dërgojnë çdo muaj në zyrat rajonale të shërbimit social shtetëror, listën e përfituesve të ndarë sipas pikës 1/a, 1/b, 1/c dhe 1/ç të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.869, datë 18.6.2008.

10. Zyrat Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dërgojnë në çdo bashki/komunë listën e invalidëve të punës të vlerësuar nga KMCAP-të ".

Pra, siç shihet, është detyrimi i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, që për rastin në fjalë duhet të dërgonte pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, Tiranë, listën e përfituesve, ku bënte pjesë dhe ankuesi, dhe moszbatimi korrekt i akteve nënligjore ka sjellë si pasojë që shtetasi S.C të mos përfitojë shtesën në pensionin e invaliditetit, si përfitim paaftësie.

Për sa më sipër, me qëllim që shtetasit të përfitojnë shtesën mbi pensionin e invaliditetit, si përfitim paaftësie, brenda afateve të përcaktuara ligjore, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: *"Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike";*

REKOMANDOJMË:

Marrjen e masave:

- 1. Për dërgimin çdo muaj të listës së invalidëve të punës në Zyrën Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, Tiranë, në zbatim të Udhëzimit nr.1406 datë 30.07.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit të nevojshëm për dhënien e përfitimit, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.869 datë 18.06.2008 “Për zbatimin e Ligjit Nr.7889 datë 14.12.1994 “Për Statusin e Invalidit”.*
- 2. Për mospërsëritjen në të ardhmen të rasteve të tjera të ngjashme, për mospërfitimin e shtesës mbi pensionin e invaliditetit, si përfitim paaftësie.*

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, ku thuhet se;

“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, kërkesë apo propozim për shkarkim, duhet t’a shqyrtojnë rekomandimin, kërkesën apo propozimin për shkarkim dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit, kërkesës apo propozimit për shkarkim. Përgjigja duhet të përmbajë shpjegime të arsyetuara për çështjen në fjalë, si dhe çfarë veprimesh, mosveprimesh apo masash ka ndërmarrë ai organ”;

Lutemi të na vini në dijeni për qëndrimin tuaj, ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,

K O M I S I O N E R I

Ermir KAPEDANI